VENDIM
Nr. 631, datë 1.10.2014

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NGA QEVERIA SHQIPTARE PËR QEVERITË E BOSNJË-HERCEGOVINËS DHE SERBISË PËR LEHTËSIMIN E PASOJAVE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA PËRMBYTJET NË MAJ 2014

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nenit 10, të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare nga qeveria shqiptare për qeveritë e Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë, përkatësisht, nga 100 000 (njëqind mijë) euro, për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në maj 2014.

2. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në programin buxhetor 01120 "Mbështetje diplomatike jashtë shtetit", t'i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 200 000 (dyqind mijë) eurosh, shpenzime korrente, për t'u përdorur si ndihmë financiare për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet e muajit maj 2014, në Bosnjë - Hercegovinë dhe Serbi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi i kontin-gjencës, miratuar për vitin 2014.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama